

VENDIM
Nr. 762, datë 12.11.2014

**PËR MËNYRËN E ORGANIZIMIT DHE TË DHËNIES SË KUJDESIT PËR
SHËNDETIN MENDOR PËR PERSONAT QË GJENDEN NË INSTITUCIONET
REZIDENCIALE TË PËRKUJDESJES SOCIALE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të paragrafit të dytë të nenit 18, të ligjit nr. 44/2012, “Për shëndetin mendor”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Personave që gjenden në institucionet rezidenciale të përkujesjes sociale, me qëllim parandalimin apo trajtimin e çrregullimeve të shëndetit mendor, u ofrohet kujdes për shëndetin mendor nga të gjitha nivelet e ofrimit të këtij kujdesi, parashikuar në pikën 1, të nenit 10, të ligjit 44/2012, “Për shëndetin mendor”.

2. Kujdesi i parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi, ofrohet sipas rregullave të përgjithshme të organizimit dhe të funksionimit të shërbimeve të shëndetit mendor në Republikën e Shqipërisë.

3. Personat që gjenden në institucionet rezidenciale të përkujesjes sociale, në nivelin parësor të ofrimit të kujdesit për shëndetin mendor, mund të ndiqen nga mjeku i kontraktuar nga ky institucion, por, në çdo rast, çdo rezident duhet të regjistrohet në qendrën shëndetësore që mbulon territorin e lokalizimit të këtij institucioni.

4. Ngarkohen ministria përgjegjëse për shëndetësinë dhe Fondi i Sigurimeve të Detyrueshme të Kujdesit Shëndetësor të përcaktojnë ngarkesën për çdo mjek familjeje të qendrave shëndetësore, të parashikuara në pikën 3, të këtij vendimi.

5. Shërbimi i specializuar për shëndetin mendor, për personat në nevojë për këtë shërbim, do të ofrohet nga qendrat komunitare të shëndetit mendor dhe, në mungesë të këtyre të fundit, nga mjeku specialist psikiatër/ neuropsikiatër pranë poliklinikave në rrethet përkatëse.

6. Strukturat rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe strukturat lokale të shëndetit publik institucionalizojnë bashkëpunimin, përmes miratimit të planeve të përbashkëta të punës, për dhënien e shërbimit shëndetësor konform përcaktimeve të këtij vendimi.

7. Shërbimi psiko-social i institucioneve rezidenciale të përkujesjes sociale bashkëpunon ngushtësisht me shërbimin psiko-social pranë strukturave lokale të shëndetit publik, pjesë të ekipeve multidisiplinare, pranë qendrave komunitare të shëndetit mendor.

8. Shërbimi i specializuar me shtretër, për shëndetin mendor, ofrohet vetëm me referim të qendrave komunitare të shëndetit mendor dhe, në mungesë të tyre, nga mjeku specialist psiki-atër/neuropsikiatër i rrethit dhe vetëm atëherë kur janë shteruar të gjitha mundësitë e trajtimit ambulator/komunitar të pacientit, me qëllim shmangien e institucionalizmit të tij.

9. Personat me çrregullime të shëndetit mendor, të cilët kërkojnë vlerësimin e aftësisë për punë, do të paraqiten në komisionet mjekësore, të cilat do t'i rekomandojnë për dërgimin në Komisionin Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP), sipas legjislacionit në fuqi.

10. Ngarkohen ministria përgjegjëse për shëndetësinë dhe ministria përgjegjëse për politikën sociale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama